



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 6228 Prot.

Laç, me 11.12.2019

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Ne Lac, sot me date 11.12.2019

Une, Mikeda Cenaj, me detyrë Përmbaues Gjyqësore pranë Zyres Përmbauese Kurbin, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbauese Nr.538 regjistri themeltar të vitit 2019 bazuar në Urdherin e ekzekutimit të datës 06.05.2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin,

KONSTATOVA:

Se është depozituar pranë Zyres së Përmbaimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor penal) nr. 528-72 të datës 30.04.2019 të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin
- Debitor: Vjollca Mark Lleshi i dtj. 05.03.1976 me banim në Fushe-Mamurras.
- Me objekt: Pagim shpenzime procedurale + tarifat fikse përmbauese.

Nga ana e zyrës tona përmbauese kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbauesor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultoi se debitori Vjollca Mark Lleshi i dtj. 05.03.1976 nuk merr dijeni nëpërmjet sherbimit postar dhe si rezultat i kësaj bazuar në nenin 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të behet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria Rr.Gj. Kurbin për shpenzimet procedurale dhe tarifat fikse përmbauese në masën 8000 leke.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedurës Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Përmbauesor Gjyqësor", i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditore (duke marrë parasysh edhe komunikimin postar) nga data 11/12/2019 - 30/12/2019 të debitorit Vjollca Mark Lleshi i dtj. 05.03.1976 me banim në Fushe-Mamurras.

2-Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kësaj zyre, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Njësise Administrative Mamurras, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Vjollca Mark Lleshi i dtj. 05.03.1976 me banim në Fushe-Mamurras.

4-Palë debitore Vjollca Mark Lleshi i dtj. 05.03.1976 me banim në Fushe-Mamurras, duhet të paraqitet pranë Zyres Përmbauese Kurbin me seli në Lgji nr.4, Lac në katin e parë në ambientet e Gjykates së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me përmbauesin gjyqësor të çështjes përmbauese për t'ju vënë në dispozicion aktet përmbauese, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 11.12.2019.

**PERMBAUES GJYQËSOR
MIKEDA CENAJ**